

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi kryetar i kolegjit, Gani Zabeli dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.H. nga ..., rruga "...", ..., për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.209/2013, datë 30.03.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 21.06.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.209/2013, datë 30.03.2016, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarin B.H. për veprën penale mashtrimi, nga neni 335 par. 1 të KPRK-së, për të cilën është shpallë fajtorë, më afër të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, ekzekutimi i të cilit do të shtyhet në afat prej 3 (tri) vite, me kusht që i akuzuari brenda kësaj periudhe nuk do të kryej veprë tjetër penale, ndërsa dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, e merr si të vërtetuar dhe urdhëron që i akuzuari këtë dënim ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën në afatin e caktuar, gjykata dënimin e shqiptuar me gjobë konform dispozitës së nenit 46 par. 3 të KPRK-së do t'ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) €, do të llogaritet në 1 (një) ditë burgim.

Aktgjykimi i ankimuar në pjesën tjetër ngel i paprekur.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.209/2013, datë 30.03.2016, të akuzuarin B.H., e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335 par. 1 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, ekzekutimi i të cilit është shtyrë për 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, me kusht që i akuzuari brenda kësaj periudhe nuk kryen veprë tjetër penale. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e paraparë ligjor, atëherë i

njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke e llogaritur sipas nenit 46 par. 4 të KPRK-së. Është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 30 €, ndërsa në emër të paushallit shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, vetëm për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me burg efektiv.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.694/16, datës 23.05.2016, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burg efektiv ose ankesa të trajtohet si jo lëndore ashtu që gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim, prokurori me ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë është i butë në krahasim me veprën e kryer penale e posaçërisht pasojat konkrete dhe rrezikshmërinë shoqërore të saj. Gjykata i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, ndërsa rrethanat rënduese nuk i ka marrë për bazë dhe nuk i ka vlerësuar aq sa duhet, është dashtë të marrë për bazë edhe rrethanat rënduese dhe atë: shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale, faktin se në rastin konkret tani i dëmtuari – B.H.2 me rastin e kësaj vepre penale është dëmtuar dhe ka kërkuar nga i akuzuari ta përmbush marrëveshjen por pa sukses. Po ashtu, theksohet se gjykata është dashur të vlerësoj

edhe rrezikshmërinë shoqërore për faktin se veprat penale të kësaj natyre janë mjaft të shpeshta dhe se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit nuk do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat ligjore e njëherit nuk do të ketë ndikim edhe ndaj personave tjerë që në të ardhmen të përmbahen që të mos kryejnë vepra penale të kësaj natyre.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të Prokurorit janë të bazuara vetëm sa i përket kohës së verifikimit të dënimit, por jo edhe për shqiptimi e një dënimi me burg efektiv. Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes dhe caktimit të llojit të dënimit, i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform dispozitave të nenit 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësues për të akuzuarin ka marrë parasysh faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihet në barrë, me çka i ndihmoj gjykatës në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, se është penduar thellë, pastaj mori për bazë sjelljen e tij korrekte para gjykatës, faktin se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa si rrethana rënduese mori parasysh faktin se kryerja e veprave penale të kësaj natyre është në rritje e sipër. Vlerësimin e këtyre rrethanave relevante për matjen e dënimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe kjo gjykatë, mirëpo gjen se edhe në pranin e këtyre rrethanave dënimi i shqiptuar me burgim e i kushtëzuar nuk është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale dhe nuk është i mjaftueshëm që të arrihet qëllimi i ndëshkimit, e duke pasur parasysh pretendimet në ankesën e Prokurorit, kjo gjykatë të akuzuarit ia shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh të cekurat më lartë, rrethanat e rastit konkret me të cilën i dëmtuari është mashtruar që të bëjë marrëveshje për shitblerjen e automjetit, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material. Gjykata e Apelit vlerëson se rrezikshmëria shoqërore e kësaj vepre penale, si dhe mënyra e kryerjes së veprës penale janë rrethana të cilat nuk janë vlerësuar në masë të duhur nga gjykata e shkallës së parë e të cilat ndikojnë në shqiptimin e një dënimi më të ashpër, siç me të drejtë pretendohet në ankesën e Prokurorit, prandaj në pranin e këtyre rrethanave kjo gjykatë të akuzuarit i shqiptoj dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, me bindje se ky dënim është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga kjo gjykatë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform të dispozitës së nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.651/2016 datë 21.06.2016

Bashkë. Profesional
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit
Rasim Rasimi

Anëtarët e kolegjit

Gani Zabeli
Ferit Osmani